



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 13.7, 14.7, lidhur me nenin 16.2 dhe nenit 19.2 dhe 33 të Ligjit për planifikimin hapësinor nr. 2003/14, të datës 03.07.2003, të shpallur sipas Rregullores nr. 2003/30, dt. 10.09.2003; nenit 3, par.1, pika b, të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45, dt. 11 gusht 2000; nenit 19, par.1, pika b. dhe të nenit 40, par.3, pika II. të Statutit dhe Rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 22.11.2005 merr

V E N D I M

PËR FILLIMIN E HARTIMIT TË PLANIT RREGULLATIV PËR LAGJET “DUKAGJINI” DHE “MUHAXHIRËT” NË PRISHTINË

Neni 1

Fillon hartimi i Planit rregullativ për lagjet “Dukagjini” dhe “Muhaxhirët”, në Prishtinë.

Neni 2

Qëllimi i nxjerrjes së Planit rregullativ, sipas këtij Vendimi, është harmonizimi i planeve urbanistike ekzistuese të lagjes, nga neni 1 i këtij Vendimi, me dispozitat e Ligjit për planifikimin hapësinor, në bazë të të cilit plan rregullativ do të bëhet caktimi i kushteve për rregullimin e hapësirës, si dhe caktimi i rregullave të lokacionit të objekteve, linjave rregulluese, linjave të ndërtimit, normave teknike urbanistike dhe kushteve tjera lidhur me lokacionin e ndërtesave dhe ndërtimeve tjera në ngastrat brenda kufijve të përshkruar me nenin 3 të këtij Vendimi, konform destinimeve të planifikuara me Planin strategjik-zhvillimi urban i Prishtinës, të miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës nr. 01-031-1231/1, dt. 02.07.2004.

Neni 3

Me Planin rregullativ, nga neni 1 i këtij Vendimi, do të përpunohet pjesa e territorit të qytetit të Prishtinës, e emërtuar si lagja “Dukagjini” dhe “Muhaxhirët”, e cila përfshinë hapësinrën e kufizuar brenda rrugëve: “Eqrem Çabej”, “Enver Maloku”, “Armend Daci”, përbri Varrezave të Dëshmorëve, deri te rrugët: “Rrustem Statovci”, “Adrian Krasniqi” dhe “Agim Ramadani”, me një sipërfaqe të përafërt prej 60.00 ha .

Neni 4

Bartës i detyrës programore dhe i hartimit të Planit rregullativ, sipas këtij Vendimi, do të jetë Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe i Ndërtimtarisë i Komunës së Prishtinës.

Në hartimin e Planit rregullativ, sipas këtij Vendimi , mund të angazhohet edhe ndihmë profesionale dhe teknike nga jashtë.

Neni 5

Mjetet financiare plotësuese për hartimin e Planit rregullativ, sipas këtij Vendimi, do të sigurohen nga buxheti i Komunës së Prishtinës.

Neni 6

Afati i hartimit të Planit rregullativ, nga neni 2 i këtij Vendimi, do të jetë periudha 6 muajshe, duke llogaritur nga dita e miratimit të këtij Vendimi nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

Neni 7

Plani rregullativ, sipas këtij Vendimi, do të miratohet me vendim të Kuvendit të Komunës së Prishtinës si Projektplan, në mënyrë që, i njëjti, t'i nënshtrohet diskutimit publik para finalizimit dhe miratimit përfundimtar të tij.

Neni 8

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Bordi i drejtorëve i Komunës së Prishtinës. Drejtoratet e Komunës së Prishtinës, janë të obliguara që t'i sigurojnë dhe t'i dërgojnë shënimet e nevojshme për hartimin e Planit rregullativ, sipas këtij Vendimi, Drejtoratit të Planifikimit, Urbanizmit dhe të Ndërtimtarisë.

Neni 9

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01 Nr. _____, më _____.2005

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri